




# Studime te Shkurtra Biblike



Eckhard Neumann

Dishepullimi





Eckhard Neuman

**Dishepullimi**

Josua-Verlag

© Shtëpia botuese „Josua“  
Shoqata e misionit kristian „Joshua“   
Kirchsteig 6  
12524 Berlin

1. Botimi 1996

## Përbajtja

---

Hyrje .....	4
Kapitulli 1 - Shembuj biblikë për dishepullimin .....	6
Kapitulli 2 - Párimet biblike të dishepullimit .....	20
Kapitulli 3 - Rreziqet në dishepullim .....	35
Kapitulli 4 - Pérvoja .....	38
Kapitulli 5 - Dishepullimi personal .....	44
Mbyllja .....	49

I kushtohet gruas sime të dashur Christel, e cila ka ndarë me mua në shërbim gjithë gëzimet dhe pengesat.

## Hyrje

Parimi i dishepullimit është një parim shumë i efektshëm. Ai del në pah më së qarti tek Jezusi.: Tre vite rresht puna e parë e tij qe mësimi i dishepujve. Jezusi jetonte me ta, i këshillonte, i qortonte, iu formonte karakteret etj ... Kur ai, pas tre vitesh veprimtarie, u largua nga toka, pas vdekjes dhe ringjalljes së tij, dishepujt e tij ishin në gjendje ta çonin Mbretërinë e Perëndisë në të gjithë botën. Ata pastaj, vepruan siç i kishte porositur ai. Në këtë mënyrë, dishepujt shkuan në gjithë botën dhe pastaj, siç e dimë, njeri prej tyre (Juda) doli nga grupi. Por rrënjet e dishepullimit shkojnë thellë deri prapa në Dhjatën e vjetër. Në kornizën e këtij studimi të shkurtër do të përmenden gjashtë shembuj biblikë për dishepullimin, nga të cilët tre gjenden në Dhjatën e vjetër dhe tre në Dhjatën e re. Megjithatë, ka edhe të tjerë të cilët cilësohen si dishepuj, por jo në atë kuptim që përshkruhet këtu. Ky studim i shkurtër u mbështet vetëm tek Bibla, megjithëse pata në dispozicion edhe libra të tjerë për dishepullimin. Pra, si masë e vetme në konceptin e dishepullimit duhet të shërbejë Bibla. Kësaj i shtohet edhe përvoja që kam mbledhur në shkollat e dishepullimit.

Që prej vitit 1984 zhvillohej çdo vit një kurs katërmujor (shkolla e dishepullimit), udhëheqjen e të cilit e kisha unë me gruan time. Pastaj vijnë kontakte me mësues dhe drejtues të lëvizjeve shkollore dishepullore në vende të tjera. Në fillim lëvizjet dishepullore u luftuan ashtu si çdo gjë e re. Kjo, me siguri për arsyen se parimet biblike të dishepullimit nuk ishin bërë të njohura dhe nuk ishin publikuar. Gjithashtu hamendësohej se në lëvizjet shkollore dishepullore kishte motive që nuk i shërbenin Mbretërisë së Perëndisë. Më vonë, për fat të mirë, ky

mëndim ndryshoi katërcipërisht. Mendimi biblik i dishepullimit zuri vend aty nga vitet 1984/85. Dishepullimi u bë modern. Këtu kontribuoi edhe literatura e larmishme nga vende të tjera. Aty përshkruheshin përvaja pozitive me parimin e dishepullimit. Tani dishepullimi u bë i modës. Disa shoqata dhe bashkësi nisën të bëjnë përpjekje për fillimin e punës dishepullore. Mjerisht, duhet pohuar se tani vihet re një zhvlerësim i konceptit të dishepullimit në vend. Dishepullimi nuk bëhet më cilësi. Arrihet deri aty sa orët rimore deklarohen si dishepullim vetëm sepse aty trajtohen tema dishepullimi. Por ky nuk është në asnjë mënyrë dishepullimi biblik. Në kornizën e këtij studimi të shkurtër, me anë të përmendjes së gjashtë shembuje biblikë, do të nxirren gjashtë parime biblike të cilat karakterizojnë dishepullimin. Do të tregohen shkurt edhe rreziqe e përvaja. Në fund të parathënes po japim edhe fjalën kryesore biblike për dishepullimin. Gjendet tek

2. Timoteu 2,2:

**„Dhë ato që dëgjove nga unë para shumë dëshmitarëve, jepua njerëzve besnikë, që do të janë të aftë të mësojnë edhe të tjerë.“**

Dishepullim do të thotë : Investim tek njerëz besnikë, të cilët janë të aftë të përcjellin më tej atë që kanë marrë. Kështu ka punuar Jezusi. Edhe në pesë shembujt e tjerë u investua po në të njëjtën mënyrë tek njerëzit. Suksesi i Jezusit, i cili e çoi ungjillin në të gjithë botën, duhet të na nxisë të vrashim mendjen.

## *Kapitulli 1* *Shembuj biblikë për dishepullimin*

---

Njeri pas tjetrit do të trajtohen tre shembuj nga Dhjata e vjetër: Joshua; Elisha dhe nxënësit e profetëve.

Më tej, tre shembuj nga Dhjata e re: Dishepujt e Gjonit, dishepujt e Jezusit dhe një dishepull i Palit (Timoteu).

Shembujt e Dhjatës së vjetër do të shënohen me a - c, ato të Dhjatës së re me A - C.

### **a) Joshua:**

Joshua paraqet ndoshta shëmbullin më të qartë të dishepullimit në Dhjatën e vjetër. Tek Joshua vërehen qartë tre faza shumë të dallueshme në jetën dhe shërbimin e tij. Faza e parë: Joshua është shërbëtor i Moisiut: (Eksodi 24,13 si edhe Eksodi 16,9-10 dhe 14).

**„Moisiu u ngrit bashkë me shërbëtorin e tij Joshua dhe u ngjit në malin e Perëndisë.“**

**„Dhe Moisiu i tha Joshuas: Zgjidh për ne disa burra dhe dil për të luftuar kundër Amalekut; nesër do të jem në majë të kodrës me shkopin e Perëndisë në dorë. Joshua bëri ashtu siç i tha Moisiu dhe luftoi kundër Amalekut, ndërsa Moisiu, Aaroni dhe Huri u ngjitën në majë të kodrës. Pastaj Zoti i tha Moisiut: Shkruaje këtë ngjarje në një libër, që të mos harrohet kurrë, dhe njofto Joshuan që unë do ta fshij fare kujtimin e Amalekut nën qiellin.“**

**Perëndia i tha Moisiut, udhëheqësit të pjekur në frysë:  
Njofto Joshuan.**

Ai duhet ti njoftonte Joshuas atë që kishte mësuar nga Perëndia. Vetë Joshua i shërbente Moisiut.

**„Joshua, biri i Nunit, i shërbente Moisiut  
qysh në të ri ...“**

Këtu është me siguri fjala për shërbime tokësore. Ndoshta Joshua sillej në mënyrë të atillë që shërbimin ndaj Moisiut e kuptonte si shërbim ndaj Perëndisë. Nëse ne nuk kemi durim të shërbejmë, nuk ndërtojmë asgjë në Mbretërinë e Perëndisë. Joshua, si shërbëtor, ishte gjithnjë pranë të zotit (lexo Eksodin 32,17). Ai ishte në bashkësi te përhershme me Moisiun. Për këtë arësy nuk ishte pranë popullit, i cili mëkatonte, por pranë të zotit dhe kështu u ruajt nga mëkat. Në fazën e dytë të jetës së Joshuas vërejmë se ai është shërbëtor dhe dishepull (Eksodi 33,11).

**„Kështu Zoti fliste me Moisiun ballë për  
ballë ashtu si njeriu flet më mikun e tij;  
pastaj Moisiu kthehej në kamp. Por  
Joshua, biri i Nunit shërbëtori i tij i ri,  
nuk largohej nga cadra.“**

Tani nis shërbimi i tij frysë. Këtu tregohet se Joshua rrinte përherë në cadrën, e cila ishte banesa e Perëndisë. (Ai nuk largohej nga cadra). Për të pasur sukses në shërbimin frysë duhet të kesh domosdo pjekuri. Joshua duhet ta ketë patur patjetër këtë pjekuri. Ndërkohë që ishte ende në shërbim të Moisiut (lexo Numrat 11,28) ai nis të marrë formë si dishepull. Mirëpo në fillim ai kishte një kuptim shumë të pakët frysë. Tek Numrat 11 tregohet se Perëndia deshi të paiste 70'burra nga më pleqtë e Izraelit me frysën që gjendej mbi Moisiun. Dhe Bibla

thotë: „**Dhe kur Fryma u vu mbi ta, ata bënин profeci  
dhe nuk pushonin.**“ (Vargu 25)

Por dy burra, Eldadi dhe Medadi, të cilët ishin në listë, kishin qëndruar në kamp dhe përjetuan aty po të njejtën gjë që përjetuan burrat jashtë kampit. Dhe tani vjen reagimi i Joshuas (vargu 28):

„**Atëhere Joshua, biri i Nunit dhe shërbëtor  
i Moisiut qysh në të ri, filloi të thotë: Moisi,  
imzot, bëji që të heqin dorë!**“

Përgjigja e Moisiut.(vargu 29):

„**Por Moisiu iu përgjegj: Ndofta je xheloz  
për mua? Ah, le të ishin të gjithë profetë në  
popullin e Zotit dhe dhëntë Zoti që fryma e  
tij të vihet mbi ta!**“

Moisiut iu desh ta korigjonte këtu Joshuan. Por Joshua rritet sepse ai i pranon mësimet. Kjo bëhet e qartë sidomos kur Moisiu e cakton atë vëzhgues bashkë me të tjerë, kur ai shkon tek vendi dhe kur më vonë, tok me Kalebin nuk është i të njejit mendim me pjesën tjeter të vëzhguesve (Numrat 14,6-9, 30.36 dhe 38).

„**Joshua, biri i Nunit, dhe Kaleb, biri i Jefunit, që ishin ndër ata që kishin vëzhguar vendin, grisën rrrobat e tyre, dhe i folën kështu asamblesë së bijve të Izraelit: Vendi që kemi përshkuar për ta vëzhguar është një vend i mirë, shumë i mirë. Në rast se Zoti kënaqet me ne, do të na çojë në këtë vend dhe do të na japë neve, një vend ku rrjedh qumësht dhe mjaltë. Vetëm mos ngrini krye kundër Zotit dhe mos kini frikë nga populli**

i vendit, sepse ne do ta hamë atë si bukë. Mbrojtja e tyre është larguar nga ata dhe Zoti është me ne. Mos kini frikë nga ata.“

„.... nuk do të hyni me siguri në vendin ku u betova se do të banoni, me përjashtim të Kalebit, birit të Jefunehut, dhe të Joshuas, birit të Nunit.“ „Kështu, të gjithë burrat, që Moisiu i kishte dërguar të vëzhgonin vendin dhe që kur u kthyen e shtynë gjithë bashkësinë të murmuronte, vdiqën nga plagët para Zotit.“

„Por Joshua, biri i Nunit dhe Kalebi, biri i Jefunehut, mbetën të gjallë ndër gjithë ata që kishin shkuar të vëzhgonion vendin“

Joshua dhe Kalebi i dhanë popullit guxim për ta pushtuar vendin. Ata kishin një vështrim të vërtetë frymëror (vëre sidomos vargun 9). Joshua ishte pjekur në frymë. Pastaj filloj fazë e tij e tretë. Joshua u bë udhëheqës i popullit ashtu siç kishte qenë Moisiu (Numrat 27,18-19).

„Dhe Zoti i foli Moisiut: Merr Joshuan, birin e Nunit, njeriun brenda të cilit është fryma, dhe verë dorën tënde mbi të; pastaj do ta paraqitësh para priftit Eleazar dhe para gjithë bashkësisë së bijve të Izraelit.“

Lexojmë tek Numrat 27,22-23:

„Moisiu, pra, bëri ashtu siç e kishte urdhëruar Zoti; mori Joshuan dhe e paraqiti para priftit Eleazar dhe tërë bashkësisë; pastaj vuri duart e tij mbi të dhe i dha urdhra ashtu si kishte urdhëruar Zoti me anë të Moisiut.“

Perëndia mundi ta përdorte Joshuan meqë ai ishte i qëndrueshëm dhe i pranonte mësimet. Perëndia nuk kërkon njerëz me mundësira të mëdha, por njerëz të mbushur plot me Frymën e shenjtë. Dhe tani Joshua ishte në gjendje ta udhëhiqte popullin. Perëndia thotë se ata duhet të ndanin vendin (Numrat 34,18).

**„Do të merrni një prijës nga çdo fis, për të bërë ndarjen e vendit.“**

Perëndia i thotë më tej Joshuas „**Ji i fortë**“, gjashtë herë gjithsej (lexo Ligji i ripërtërirë 31,6-8 si dhe Joshua 1,6-7 dhe 9). Një udhëheqës duhet të jetë zemërfortë, plot besim, sepse kur udhëheqësin e lëshon zemra, gjithë grupin e lëshon zemra. Joshua e udhëheq më tej popullin në fuqinë e Perëndisë (Ligji i ripërtërirë 34,9).

**„Atëhere Joshua, biri i Nunit, u mbush me frymën e diturisë, sepse Moisiu kishte vënë duart mbi të; kështu bijtë e Izraelit iu bindën atij dhe vepruan ashtu si e kishte urdhëruar Moisiun Zoti.“**

Me anë të shtrimit të duarve ai hyri nën pushtetin e Frymës. Dhe Perëndia flet tani drejtpërdrejt me Joshuan (Joshua 1,6).

**„Ji i fortë dhe trim, sepse ti do të bësh që ky popull të zotërojë vendin që u betova tu jap etërve të tu.“**

Emri Joshua do të thotë Jezus. Moisiu i mori masat me kohë për një pasardhës. Ai i jepte atij mësime, e qortonte dhe i tregonte sesi duhej udhëhequr një popull. Dhe pasi u përgatit, Joshua qe në gjendje ta merrte përsipër këtë detyrë. Ai bëri mrekullira ashtu si Moisiu.

**b) Eliseu:**

I dyti shembull nga Dhjata e vjetër për dishepullimin është Eliseu. Vënja e tij në shërbim na tregohet tek 1. Mbretërve 19,19-21:

„Elia u nis që andej dhe gjeti Eliseun, birin e Shafatit, tek lëronte me dymbëdhjetë qe para tij, dhe ai vetë gjendej me pendën e dymbëdhjetë. Elia i kaloi afër dhe i hodhi përsipër mantelin e tij. Atëhere Eliseu la qetë dhe vrapi pas Elias, duke thënë: Të lutem, më lër të shkoj të puth atin tim dhe nënën time, pastaj do të të ndjek. Elia iu përgjigj: Shko dhe kthehu! Dhe mendohu për atë që të bëra! Me tu larguar nga ai, Eliseu mori një pendë qe dhe i ofroi si flijim; me veglat e qeve poqi mishin dhe ua dha njerëzve, që e hëngrën. Pastaj u ngrit, shkoi pas Elias dhe u vu në shërbim të tij.“

Ai që e thirri është Elia, profeti. Ai e thirri atë mu në mes të punës së përditshme. Këtu gjejmë të theksuar të njejtin radikalitet të cilin e hasim edhe tek historitë e thirrjeve në shërbim në Dhjatën e re. Eliseu i lutet Elias: Më lejo të puth babanë dhe nënën time, pastaj do të të ndjek. Elia thotë: Shko, kthehu, mendohu për atë që të bëra. Ai thotë me fjalë të tjera: Lere atë punë. Dhe Elia kupton se këtu bëhet fjalë për një përkushtim të plotë, për radikalitet në ndjekje. Ai bëri flijim, u ngrit pa u përvendetur dhe shkoi sakaq pas tij. Këtë ne e hasim në Dhjatën e re, tek Jezusi. „Zot, më lejo në fillim, ... pastaj do të të ndjek.“ Por Jezusi nuk ia lejon këtë asnjërit prej tyre (shih Luka 9,59). Sepse kush nis të bëjë kompromise, do bëjë gjithnjë kompromise: nevojat e mia dhe Jezus; Jezus dhe ...

Dhe këtu Eliseu bëhet shërbëtor i Elias. Ai nis ta ndjekë dhe ti shërbejë atij. Lexojmë më tej tek 2. Mbretërve 3,11:

„Eliseu derdhët ujë mbi duart e Elias.“

Eliseu del në pah tamam vetëm pas marrjes së Elias në qiell (lexo 2. Mbretërve 2,1-14). Dy vargje nga ky fragment:

Vargu 9

„Mbas kalimit, Elia i tha Eliseut: Kérko, çfarë do që unë të bëj për ty, para se të më largojnë prej teje. Eliseu u përgjigj: Të lutem, bëj që një pjesë e dyfishtë e frysës tënde të vijë përmbi mua:“

Vargu 14

„Dhe mori mantelin e Elias që i kishte rënë këtij nga trupi dhe rrahu me të ujrat; këto u ndanë sa andej edhe këtej dhe Eliseu kaloi përmes.“

Ai është këmbëngulës dhe shumë i qëndrueshëm në ndjekje. Tre herë radhazi ai nuk stepet. Më në fund, pas gjithë të luturave, ai merr dyfishin e frysës (bëhet fjalë për Frymën e Shenjtë që gjendej mbi Elian). Dhe gjithshka nisi me shërbime, me nënshtrim që duket sheshit tek Eliseu.

Në kapitullin 2. do të shtjellohet se Eliseu kreu vërtet dyfishin e bëmave të shembullit të tij, Elias. Ai kreu pjesërisht të nejstat bëma, por këto, siç na tregon Bibla, janë nga sasia sa dyfishi i bëmave të Elias.

### c) Dishepujt e profeteve:

Tek 2. Mbretërve 2 na tregohet për një numur të madh dishepujsh të profetëve: në Bethel, në Jeriko dhe 50 në Jordan. Ata bënин jetë të përbashkët. Kryenin shërbime praktike. Kështu lexojmë tek 2. Mbretërve 6,1-7 një tregim për një druprerës që kish marrë hua hekurin e sëpatës. Ata mësonin nën udhëheqjen e burrave të perëndishëm me përvojë. Një nga këta burra të perëndishëm ishte Eliseu (shih 2. Mbretërve 6,1-7 si shembull). Pastaj Eliseu dërgon një dishepull profeti në Ramoth, për të vajosur si mbret të Izraelit kapitenin Jehu (2. Mbretërve 9,1-6). Nën udhëheqjen e burrave të perëndishëm me përvojë ata mësonin të profetizonin dhe ishin në gjendje ta bënин këtë pastaj.

### 2. Mbretërve, 3-5

„Dishepujt e profetëve që ishin në Bethel shkuan pastaj ta takojnë Eliseun dhe i thanë:

A e di që Zoti do ta çojë sot zotin tënd përmbi ty? Ai u përgjigj: Po, e di; heshtni!“

„Dishepujt e profetëve që ishin në Jeriko iu afroan Eliseut dhe i thanë: A e di që Zoti do ta çojë sot zotin tënd përmbi ty? Ai u përgjigj: Po, e di; heshtni!“

Pra, dishepujt e profetëve patën përshtypje profetike. Ata pastaj u bënë vetë profetë (lexo 1. Mbretërve 20,35-41). Ia vlen të shihet edhe pohimi tek 1. Mbretërve 18,13, me anë të të cilit vërtetohet se ekzistonte një numur i madh profetësh:

„A nuk i kanë njoftuar zotërisë sime atë që unë kam bërë kur Jezebeli vriste profetët e Zotit? Si fsheha njëqind nga këta profetë të Zotit, pesëdhjetë në një shpellë dhe pesëdhjetë në një tjetër, duke i furnizuar me bukë dhe me ujë?“

## 2. Mbretërve 4,1

„Një grua, bashkëshortja e një dishepulli të profetëve, i thirri Eliseut duke i thënë: Shërbëtori yt, burri im, vdiq, dhe ti e di që shërbëtori yt kishte frikë nga Zoti; tani huadhënësi ka ardhur për të marrë dy bijtë e mi, për t'i bërë sklevër të tij.“

Sic shihet, vepronte një numur i madh profetësh.

### A) Dishepujt e Gjonit:

Për ta nuk dëmë dhe aq shumë. Ata jetonin bashkë me Gjonin dhe i shërbën atij. Ata dëgjonin dhe shikonin sesi predikonte dhe pagëzonte Gjoni në Jordan. Gjoni i mësonte ata të luteshin (lexo Luka 11,1). Kur u shfaq Jezusi, dy prej tyre kaluan menjëherë në anë të tij (lexo Gjonit 1,35-41). Ja dy vargje:

Vargu 35

„Të nesërmen Gjoni rrinte atje me dy nga dishepujt e vet.“

Vargu 37

„Dhe të dy dishepujt dëgjuan atë duke folur dhe e ndoqën Jezusin.“

Përmenden edhe dishepuj, të cilët Gjoni i dërgon tek Jezusi:

Mateu 11,2

„Por Gjoni, që kishte dëgjuar në burg të flitej për veprat e Krishtit, dërgoi tek ai dy nga dishepujt e vet.“

Me këtë dërgim Gjoni deshi të merrte vesh nëse Jezusi ishte me të vërtetë Mesia. Për dishepujt e Gjonit na tregohet se ata kishin agjëruar.

Mateut 9,14

„Atëhere iu afruan dishepujt e Gjonit dhe i thanë: Përse ne dhe farisenjtë agjërojmë shpesh, ndërsa dishepujt e tu nuk agjërojnë?“

Edhe dishepujt e Gjonit ishin njerëz që kishin braktisur mjedisin e tyre normal dhe jetonin bashkë me Gjon Pagëzorin, derisa erdhën tek Jezusi dhe u bënë dishepuj të tij.

### B) Dishepujt e Jezusit.

Shembullin më të qartë biblik për dishepullimin e gjemë tek Jezusi. Jezusi i thërrret dishepujt e tij që ta ndjekin. ‘Më ndiq pas! Ata iu përgjigjën duke braktisur gjithshka. Ata ndoqën pas mjeshtrin e tyre (shih thirrjen e Mateut tek Mateu 9,9).

Prej tyre, prej një grumbulli të thirrurish, ai zgjodhi dymbëdhjetë dishepuj pas një nate lutjeje. Ata ishin pjesërisht njerëz jo të zakonshëm. Për shembull, një tagrambledhës (këta si rregull bashkëpunonin me romakët), një terrorist (zelotët ishin terroristë të asaj kohë), një Thoma, i cili shprehimi shqiptar si dyshues, një Simon-Pjetër shumë gjaknxehtë (emri Simon do të thotë kallam dhe ai i tillë ishte) etj ... Jezusi jetoi tre vjet bashkë me ta. Ai i lëvdonte, i qortonte dhe formonte në këtë mënyrë karakteret e tyre. Dishepujt i shërbënin mjeshtrit dhe kryenin pjesërisht punë tepër të thjeshta. Dishepujt dëgjonin me vëmendje sesi Jezusi predikonte plot pushtet. Ata e pyesnin kur nuk kuptionin diçka. Ata shihnin si Jezusi shëronte dhe dëbonte démonët,

si bekonte fëmijët. Ata i nënshtroheshin mjeshtrit të tyre. I pranonin me dëshirë mësimet (ekstra). Dhe pastaj Jezusi i dërgonte gjithandej. Gjithashtu, Jezusi kishte liri të merrte shpeshherë me vete tre prej tyre për shërbime të veçanta. Në shkollën e tij ata përjetuan thyerjen e krenarisë (p.sh. tradhëtia e Pjetrit). Ai i quante ata besimpakë. I qortonte dhe tmerrohej nga mosbesimi i tyre. I lëvdonte dhe qe për ta një drejtues i shkëlqyer. Ai i mbrojti në Gjetsemani, bile deshi edhe tradhëtarin që bëntë pjesë në grup. Ai punoi me ta si vizioner në besim, duke ua ngulitur atyre këtë besim, p.sh. Pjetrin e quajti shkëmb në një kohë kur ky nuk ishte fare i tillë. Ai vepronte si udhëheqës shpirtëror. Pyetja e trihershme drejtuar Pjetrit: 'Më do ti mua?' e vërteton këtë. Pastaj ai i udhëzoi të shkonin në Jeruzalem, për tu pagëzuar me Frymën e shenjtë (Veprat e apostujve 1,4-5).

**„Dhe, duke u gjendur bashkë me ta, i urdhëroi ata që të mos largoheshin nga Jeruzalemi, por të prisnin premtimin e Atit: Që, tha ai, e keni dëgjuar nga unë, sepse Gjoni pagëzoi me ujë, por ju do të pagëzoheni me Frymën e shenjtë pas jo shumë ditësh.“**

Dhe kjo pastaj ndodhi:

Veprat e apostujve 2,1-4

**„Kur erdhi dita e Rrëshajeve, ata ishin të gjithë bashkë, në një mendje të vetme, në të njejtin vend. Dhe befas nga qielli erdhi një ushtimë, si ajo e një ere që frys furishëm, dhe e mbushi gjithë shtëpinë ku ata po rrin. Dhe atyre u dukën gjuhë, si prej zjarri, të cilat ndaheshin dhe zinin vend mbi kokën e tyre. Kështu, të gjithë u mbushën me**

**Frymën e shenjtë dhe filluan të flasin në gjuhë të tjera, ashtu si Fryma e shenjtë ua jepëtë të shpreheshin.“**

Citojmë edhe lutjen lartpriftërore (Gjonit 17,18):

**„Sikurse ti më ke dërguar mua në botë, po ashtu unë i kam dërguar ata në botë.“**

Ata e kuptuan porosinë dhe predikuan, shëruan dhe çliruan si Jezusi, pasi u paisën ashtu si Jezusi në Jordan. Pra, shërbimi i vërtetë filloi pas Rrëshajave. Por ata patën vepruar edhe më përpara.

*Shembuj nga predikimet:*

Markut 6,12-13

**„Kështu ata shkuan dhe u predikonin njerëzve që të pendoheshin ... dhe dëbonin shumë demonë dhe vajosnin me vaj shumë të lëngatë dhe i shëronin.“**

Vepr. ap. 2,14-36: Predikimi i Rrëshajave i Pjetrit.

Vepr. ap. 3,12-26: Predikimi i Pjetrit në tempull.

Vepr. ap. 10,34-43: Predikimi i Pjetrit tek Korneli.

*Shembuj për shërimet:*

Vepr. ap. 3,1-11: Shërimi nga Pjetri i të paralizuarit para derës së tempullit.

Marku 6,13: i sapocituar: Dishepujt shëronin të sëmurët.

Vepr. ap. 9,32-35: Pjetri shëron Enean.

Vepr. ap. 5,16: Të gjithë shëroheshin me anë të apostujve.

*Shembuj për shërbimin e çlirimit:*

Marku 6,13: Edhe njëherë dëbimi e fryshtave të ndyra.

*Shembuj për ringjallje nga të vdekurit:*

Vepr. ap. 9,36-43: Aty bëhet fjalë për ringjalljen e Tabeas.

Dishepujt shkuan në të gjithë botën dhe qenë pjekur si personalitetë në shkollën e Jezusit. Dhe ata bënë gjëra akoma më të mëdha se mjeshtri i tyre (shih kapitullin 2).

### C) Timoteu:

Timoteu na përshkruhet si dishepull dhe shërbëtor i Palit (Veprat e apostujve 16,1 dhe 3 fragmentare):

„Dhe ai arriti në Derbë dhe në Listra; këtu ishte një dishepull me emër Timote ...“

„Pali deshi që të dilte me të ...“

Veprat 19,22

„Atëhere dërgoi në Maqedoni dy nga ata që i shërbenin, Timoteun dhe Erastin ...“

Timoteu del me Palin dhe më pas kryen një shërbim të veçantë. Ai ishte një nxënës i Palit, një dishepull i tij që braktisi gjithshka, ndoqi jetën e trazuar të Palit dhe u rrit e u bë një shërbëtor i plotpushtetshëm.

Pas njëfarë kohe pjekurie në shërbim Pali e dërgon atë me detyra të ndryshme. Dhe Timoteu me sa duket qe i aftë ti kryente këto detyra. Pali i dha atij udhëzime të qarta sesi duhet të sillej. Udhëzimet e Palit për dishepullin e tij Timoteu janë të shumëllojshme. Ai i bën atij thirrje për luftën e besimit (1. Tim. 6,12). Kujdeset që Timoteu të mos përqmohet, kujdeset për njojjen dhe pranimin e tij nga të tjerët (1. Korintasve 16,11). Pali e këshillon atë (1. Tim. 1,3). I beson shërbime të ndryshme (1. Tim. 1,18). Pali i tregon atij si të sillet me gratë dhe me burrat (1. Tim. 2,8-15). Pali i thotë se ai (Timoteu) duhet të jetë shembull (1. Tim. 4,12). E këshillon si të ushtrohet në perëndishmëri (1. Tim. 4,7). Timoteu të kënaqet me aq sa ka (1. Tim. 6,6). Timoteu të mos hyjë në debate të kota (1. Tim. 6,5 dhe 11). Timoteu le të durojë vuajtjet (2. Tim. 2,3). Timoteu të largohet nga pasionet rinore (2. Tim. 2,22). Dhe Timoteu le të ngulmojë tek Shkrimet (1. Tim. 3,14-16). I jep po ashtu dy herë guxim të praktikojë dhunitë e Frymës, të cilat iu kanë dhënë atij.

## 2. Timoteu 1,6

„... të zgjosh dhuntinë e Perëndisë që është  
në ty me anë të vënies së duarve të mia.“

## 1. Timoteu 4,14

„Mos e lër pasdore dhuntinë që është në  
ty, e cila të është dhënë me anë profecie,  
me vënien e duarve nga ana e pleqësisë.“

Pali e cilëson Timoteun si një bir që i shërben atij me besnikëri (1. Korintasve 4,17, Filipianëve 2,22).

## *Kapitulli 2* *Parimet biblike te dishepullimit*

---

Në këtë kapitull do të përmenden parimet biblike dhe po këtu më pas do të përshkruhet sesi i përbushën këto parime gjatë dishepullimit personat e përmendur. Vargjet biblike do të nxirren kryesisht nga kapitulli 1.

### **PARIMI 1**

**Gatishmëria pér braktisjen e gjithshkaje, pér largimin ngajeta e vjetër (Dishepullimi ka një çmim, është i shtrenjtë).**

a) Joshua:

Joshua, dishepulli i Moisiut, u largua nga familja e vet dhe u bësherbëtor i Moisiut. Ai i shërbente Moisiut qysh në të ri.

b) Eliseu:

Kur Elia i hëndhi mantelin Eliseut, ky, pas një ngurrimi të shkurtër, braktisi mjedisin e tij, punën dhe familjen dhe ndoqi pa një pa dy Elian.

c) Dishepujt e profetëve:

Ata u larguan nga mjedisi ku ishin mësuar të jetonin dhe jetonin në „bashkësi“, pér të qenë kështu nën udhëheqjen e profetëve me përvojë dhe pér të mësuar (p.sh. Eliseu). Përmenden grupe në Bethel, Jeriko dhe 50 dishepuj në Jordan.

**A) Dishepujt e Gjonit:**

Ata jetonin me Gjonin dhe i shërbenin atij dhe edhe ata qenë larguar nga mjedisë familiar.

**B) Dishepujt e Jezusit:**

Ata braktisën gjithshka; profesionin, mjedisin, familien dhe i shërbenin Jezusit dhe e ndiqnin atë pas. Jezusi u tha atyre: 'Më ndiq.' Pra, Jezusi nuk hezitonte ti nxirrte ata ngajeta normale për ti futur në shërbimin e tij, për të ecur me ta. Ai kërkoi që ata të shkonin dhe të jetonin me të pa kushte, pa u ndarë dhe pa bërë kurrfarë ceremonie me njerëzit e shtëpisë. Dhe ata kështu vepruan.

**C) Timoteu:**

Ai qe dishepull i Palit. U largua nga shtëpia (nënë jude dhe baba grek) dhe udhëtonte me apostullin.

Në përfundim do të përmendim edhe njëherë fjalët radikale nga Luka 14,26 dhe 33.

**„Nëse ndokush vjen tek unë dhe nuk urren babanë e vet dhe nënën e vet, gruan dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, madje dhe jetën e vet, nuk mund të jetë dishepulli im.“**

**„Kështu, pra, secili nga ju që nuk heq dorë nga të gjitha ato që ka, nuk mund të jetë dishepulli im.“**

Jezusi bën thirrje për radikalizëm në ndjekje. Pra, dishepullim quhet së pari: Largim, braktisje e gjithshkaje dhe dorëzim i së vjetrës. Dishepullimi është vendosmëri.

## **PARIMI 2:**

**Gatishmëri pér të shërbyer, qoftë edhe shërbimet më të ulta.**

a) Joshua:

Ai i shërbente Moisiut qysh në të ri dhe përmendet si shërbëtor i Moisiut. Shërbimi i tij përbëhej nga veprimtari tokësore (zgjedhja e burrave pér luftë, vëzhgues, pritës i Moisiut në Sinai etj.) si dhe veprimtari fryshtësore (p. sh. shërbëtor në çadër).

b) Eliseu:

Ai u fut në shërbim menjëherë pas thirrjes së Elias. Lexojmë se ai derdhte ujë mbi duart e Elias.

c) Dishepujt e profetëve:

Ata shërbënin në „banesën e përbashkët“. Lexojmë pér një prerje drush me sëpatë të marrë hua. Eliseu dërgon një profet të dishepujve në Ramoth pér të vajosur një kapiten si mbret të Izraelit.

A) Dishepujt e Gjonit: Ata i shërbënin Gjonit, p.sh. dy prej tyre u dërguan tek Jezusi.

B) Dishepujt e Jezusit:

Tek ata vërehen aktivitete të shumëlojshme si p.sh. përgatitja e qengjit të Pashkës, ndarja e ushqimit katërmijëve dhe pesëmijë vetave, administrimi i parave (arka e tyre), kërkimi i banesës në një fshat të samaritanëve etj. Këtu Jezusi u jep atyre detyrën. Mendoj se vargjet korresponduese në Bibël janë shumë të njoitura.

C) Timoteu:

Pali shkruan se ai e dërgon Timoteun si shërbëtor në Maqedoni.

Gatishmëria për të shërbyer, për të kryer edhe shërbimet më të ulta, e përmendur tek ky parim është e rëndësishme. Kush duron në kryerjen e shërbimeve më të ulta do të lejohet dikur të mbajë përgjegjësi më të mëdha në mbretërinë e Perëndisë. Do të ndodhë si më shëmbëlltyrën e talentave të besuara që tregon Jezusi. Kush nuk do që të shërbejë nuk ndërton Mbretërinë e Perëndisë. Çdo shërbim duhet të jetë shërbim ndaj Perëndisë, edhe kur bëhet fjalë për sfera praktike, ashtu siç vërtetuam këtu. Para se Jezusi të fillonte të predikonte, të shëronte, të çlironte dhe të bënte mrekullira, ai i shërbente i nënshtruar dhe me besnikëri prindërve të tij derisa u bë 30 vjeç (Luka 2,51-52). Në letrën Filipianëve thuhet më tej:

#### Filipianëve 2,6-9

„Ai, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazi veten e tij duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme porsi njeri, e përuli vvetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit. Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër.“

Poshtërimi i vullnetshëm i Jezusit, shërbimi i tij, pati për pasojë lartësimin e tij nga Ati (shih vargjet 10 dhe 11 të po këtij kapitulli). Gjithshka fillon me shërbim! Pastaj vjen plotfuqia. -

Tek Veprat e Apostujve (kap. 6) mësojmë sipas cilave kritere zgjidhen burrat (kjo vlen po aq mirë edhe për gratë) për shërbime praktike, tokësore: nam të mirë, të mbushur me Frymë të shenjtë dhe urtësi. Pra, nuk konsiderohen të

rëndësishme cilësitë e jashtme si arsimprofesioni e gjëra të njëashme. Të lutem, vëre se shërbimit të Stefanit ju hap rruga kur ai nisi të shërbente për përkujdesjen e vejushave.

Veprat e apostujve 6,8

„**Stefani, plot besim dhe fuqi, bënte shenja  
dhe mrekulli të mëdha nëpër popull.**“

Para këtyre pohimeve nuk lexojmë asnjë veprimtari të Stefanit tek Veprat e Apostujve.

### **PARIMI 3:**

#### **Shkollë karakteri nëpërmjet bashkëjetesës**

Siq e pamë tek parimi 1 dishepullimi është dalja ngajeta e vjetër. Në këtë fragment do të trajtohet aftësia për të shkolluar karakterin me anë të bashkëjetesës.

a) Joshua:

Joshua gjendej përherë aty ku ishte Moisiu. Moisiu, sipas urdhërit të Perëndisë, duhej ti mësonte Joshuas gjëra të caktuara. Dallojmë sesi Joshua piqet përherë e më tepër. Shembulli me 70 pleqtë tregon kuptimin e tij të pakët frysmeror. Tek dërgimi si vëzhgues ai flet kundra me besim të plotë tek fjala e folur e Zotit. Në fillim qe shërbimi tokësor. Dhe pastaj nisi shërbimi frysmeror i Joshuas.

b) Eliseu:

Ai vërente me kujdes Elian, si ky reagonte, çfarë bënte, dhe bëri më vonë po ato gjëra dhe të tjera akoma.

c) Dishepujt e profetëve:

Ata mësonin pranë profetëve me përvojë dhe një pjesë u bënë vetë profetë.

### A) Dishepujt e Gjonit:

Pak gjëra dimë për ta nga afër. Ata ishin vazhdimisht pranë Gjonit, ndërsa disa prej tyre shkuan me Jezusin. Për ta vetëm tregohet se agjeronin.

### B) Dishepujt e Jezusit:

Jezusi i qortonte ata, p. sh. ai urredhëron disa herë mosbesimin e tyre. Ai u ndaloi atyre të bënин të binte zjarr prej qiellit. Ai i tha njëherë njerit prej tyre: largohu prej meje Satan, ti ke ne mendje gjëra njerëzore. Jezusi ishte këmbëngulës në këshillim, p. sh. i këshilloi në çështjen e taksave, i këshilloi: kush është babai im dhe nëna ime, janë ata që kryejnë vullnetin e Atit tim në qiej. Kur dishepujt e tij erdhën njëherë dhe i treguan se ia kishin ndaluar dikujt të vepronte sepse ky nuk ishte me ta dhe vepronte jashtë grupit të tyre ai tha: nuk duhet ta bënit. Jezusi, po ashtu, u jepte atyre guxim. Kështu, i dërgoi ata të shpallnin Ungjillin, të shëronin të sëmurët dhe të dëbonin demonët. Pjetrit i tha se kish dëshmuar njohjen e Birit të Perëndisë: këtë zbulesë nuk ta dha mishi dhe gjaku. Ose ai i dha sérish Pjetrit guxim me pyetjen e triherëshme të dashurisë pas tradhëtisë së këtij të fundit. Kështu, Jezusi punonte me qortim, inkurajim dhe formonte karakteret e dishepujve të tij.

### C) Timoteu:

Pali formonte vazhdimisht dishepullin e tij Timote. Ai e këshillon, i bën thirrje për luftën e besimit, kujdeset për njohjen dhe pranimin e tij, i kujton atij të praktikojë dhunitë e frysës, e mëson si të sillet me burrat dhe me gratë. Timoteu nuk duhet të merret me fjalë boshe, duhet të largohet nga pasionet rimore, duhet të qëndrojë fort tek Shkrimi etj.

#### **PARIMI 4:**

**Mësim nëpërmjet të parit, të vërejturit të një personi shembull, nxënie të dishepullit, me qëllim që të ketë efekt parimi i shumëfishimit.**

Tek ky parim bëhet fjalë: Dishepujt të vërejnë me vëmendje një person shembull dhe të mësojnë prej tij, të pranojnë me dëshirë mësimet për t'i përcjellë pastaj vetë ato më tej. Këtë e quajmë parim të shumëfishimit.

##### **a) Joshua:**

Ai vërente me kujdes çfarë bënte Moisiu. Ai pa cilësitë prej udhëheqësi të Moisiut dhe më vonë që vetë i aftë ta udhëhiqte popullin drejt vendit. Ai u bë prijës i popullit ashtu si Moisiu. Joshua nuk bëri gabimin e Moisiut. Joshuas iu dha përgjegjësia nëpërmjet shtrimit të duarve që Perëndia ia kishte urdhëruar Moisiut. Në kapitullin 1 të librit të Joshuas lexojmë se si vetë Perëndia e instrukton Joshuan që të qëndrojë si udhëheqës dhe ti prijë popullit. Gjithashu interesante është se Perëndia e këshillon Joshuan të mos e heqë fjalën e tij nga G O J A. Ai duhet të mendojë për të ditë e natë dhe ta flasë. (Këtu na thuhet qysh në Dhjatën e Vjetër se ç'qëndrim duhet të mbajmë ndaj Fjalës së Perëndisë, njëloj si tek Romakëve 10,6-10).

Në kapitullin 3 të librit të Joshuas na tregohet sesi Izraeli e kalon Jordanin në të thatë, ashtu si tek kalimi nëpër Detin e Kuq me anë të Moisiut. Në kapitullin 6 na tregohet sesi Joshua me popullin e Izraelit maryin qytetin gati të papushtueshëm Jeriko. Në kapitujt e mëtejshëm na tregohet sesi ata e sulmojnë, e pushtojnë dhe e ndajnë vendin. Kështu Joshua vazhdoi atë që Perëndia deshi të bënte nëpërmjet Moisiut. Pra, Moisiu qe i aftë të përgatiste një pasardhës, i cili do të pushtonte vendin dhe do të ishte në gjendje t'ia ndante atë popullit.

b) Eliseu:

Tek Eliseu duket veçanërisht qartë se ai ka bërë të njejtat vepra dhe më tepër sesa shembulli i tij Elia. Në disa raste ai punon kopje si Elia (krahaso tek parimi 5 „Dhunitë e frymës“). Ai kreu pothuaj dyfishin e bëmave të Elias sepse ai mori një pjesë të dyfishtë nga fryma e këtij (d.m.th nga Fryma e Shenjtë). Ai gjithashtu i priu dishepujt drejt dimensionit të profetizimit.

c) Dishepujt e profetëve:

Ata mësonin duke parë profetët me përvojë p.sh. Eliseun. Më vonë ata ishin vetë në gjendje të profetizonin. Një pjesë e tyre u bënë vetë profetë.

A) Dishepujt e Gjonit:

Pak dihet rrëth veprimtarisë së tyre. Kur doli Jezusi në skenë, siç dihet, shumica e tyre u bashkuan me të.

B) Dishepujt e Jezusit:

Ata bënë të njejtën gjë si Jezusi. Ai foli për shërbimin e tyre tek Luka 4,18-19. Ai tha në lutjen lartpriftërore (Gjoni 17,18)

„**Ashtu si ti më dërgove mua në botë,  
ashtu i dërgoj unë ata në botë** (është fjala  
për dishepujt).“

Në parimin 5 veprat e dishepujve do të numurohen një për një dhe do të shtjellohet se ata e përbushën me të vërtetë atë që thuhet në lutje. Në fillim të veprimtarisë së tyre ata u pagëzuan me Frymën e Shenjtë ashtu si ndodhi me Jezusin. Burime jashtëbiblike pohojnë se ata të gjithë përvëç Gjonit vdiqën si martirë gjatë përbushjes së urdhërit të misionit.

C) Timoteu:

Timoteu mëson të tjerë ashtu si Pali. Pali e udhëzon Timoteun si të udhëheqë drejt bashkësitë e porsaformuara (dy letrat drejtuar Timoteut). Ai e udhëzon Timoteun nga larg sesi të veprojë drejt dhe pa u nxituar në emërimin e pleqve. Timoteu vezhdon më tej veprën e Palit.

**PARIMI 5:**

**Përdorimi dhe futja në punë e dhuntive frysërore  
dhe manifestimi i Frymës së Shenjtë.**

a) Joshua:

Me anë të shtrimit të duarve ai hyri nën veprimin e Frymës. Joshua qe i aftë të bënte mrekullira ashtu si Moisiu. Ai bëri mrekulli gjatë kalimit nëpër Jordan (Joshua 3) dhe gjithashtu mrekullinë e pushtimit të Jerikos (Joshua 6).

b) Eliseu:

Nëpërmjet kalimit të vajosjes ose të pjesës së dyfishtë të Frymës së Shenjtë, Eliseu bëri dyfishin e mrekullive të Elias. Disa gjëra të krahasueshme: Një ringjalljeje e të vdekurit nga Elia sipas 1. Mbretërve 16,17-24 i përqaset një ringjallje nga Eliseu (2. Mbretërve 4). Shtimit të vajit nga Elia tek 1. Mbretërve 17,14 i përqaset shtimi i vajit nga Eliseu tek 2. Mbretërve 4,1-7. Tek Eliseu gjenden edhe gjëra të tjera si: Shërimi i ujrave të një burimi (2. Mbretërve 2,19-21); shërimi i një lebrozi (2. Mbretërve 5); një grua shterpë lind femijë (2. Mbretërve 4,14-17); një perime ë dëmshme helmuese kthehet në e ngrënshme (lexo 2. Mbretërve 4,38-41); një copë hekuri noton (lexo 2. Mbretërve 6,5-7), parashikimi i rrëthimit dhe shpëtimit të Samarisë (2. Mbretërve 6 dhe 7).

c) Dishepujt e profetëve:

Për ta na tregohet se dinin të profetizonin. Ka të ngjarë që ata morën drejtim për të vepruar në këtë aspekt nga profetët që i udhëzonin. Disa prej tyre ndoshta u bënë vetë profetë.

A) Dishepujt e Gjonit:

Në këtë aspekt nuk na tregohet gjë për ta.

B) Dishepujt e Jezusit:

Në kapitullin 1 vërtetuam me vargje nga Bibla se ata vepruan si Jezusi; predikuan, shëruan, çliruan dhe ringjallën të vdekurit. Shërbimi i tyre i vërtetë filloi kur ata u mbushën më Frymën e Shenjtë ose siç thotë Jezusi tek Veprat e Ap. 1,4 dhe 5 kur u pagëzuan me Frymën e shenjtë.

C) Timoteu:

Timoteu inkurajohet prej Palit të praktikojë dhunitë e Frymës, të cilat ai i kishte marrë me anë të shtrimit të duarve.

Pohimi që Moisiu i bëri Joshuas në Dhjatën e vjetër tek Numrat 11,29 ku Moisiu thotë - të ishte i gjithë populli profet - vërtetohet nga Pali tek mësimet e tij mbi dhunitë e Frymës në letrën Korintasve:

1. Korintasve 14,5

„Unë dua që të gjithë ju të flisni gjuhëra,  
por më tepër të profetizonit.“

1. Korintasve 14,31

„Sepse, të gjithë, njeri pas tjetrit mund të profetizojnë, që të mësojnë të gjithë dhe të inkurajohen të gjithë.“

### **1. Korintasve 14,26**

„Ç“ duhet bërë, pra, o vellezër? Kur të mblidheni, secili nga ju ka një psalm, një mësim, një fjalim në gjuhë tjetër, zbuluesë, interpretim, çdo gjë le të bëhet për ndërtim!“

Fjala e Perëndisë na thotë se me anë të pagëzimit të Frymës mund të flasim gjuhëra, të profetizojmë etj ... Secili ka - secili ka....thotë Bibla!

### **PARIMI 6:**

#### **Bindja misionare**

Natyrisht që ky qëndrim misionar nuk mund të ekzistonte në Dhjatën e vjetër sepse urdhëri i misionit i dhënë nga Jezusi daton vetëm qysh nga Dhjata e re. Lexojmë tek Mateu 28,18:

„Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell dhe në tokë. Shkon, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.“

Jezusi i dërgoi dishepujt e tij të vepronin në të njejtën mënyrë siç kish vepruar ai vetë. Dhe ai tha: Ashtu si më dërgoi Ati mua në botë, ashtu unë ju dërgoj ju në botë. Kjo nuk do të thotë gjë tjetër veçse ne duhet veprojmë, d. m. th. të predikojmë, të shërojmë dhe të çlirojmë në të njejtën mënyrë si Jezusi. Kjo del shumë qartë në pah tek Mateu 10,1:

**„Dhe ai thirri të dymbëdhjetë dishepujt e tij rrëth vetes dhe u dha autoritet t'i dëbojnë frysma e ndyra, dhe të shërojnë çdo sëmundje e çdo lëngatë.“**

Në vargjet 2 deri 4 përmenden pastaj emrat e të dymbëdhjetëve. Vargu 7: Këta të dymbëdhjetë Jezusi i dërgoi, i urdhëroi dhe foli:

**„Shkoni dhe predikoni duke thënë: Mbretëria e qieve u afrua. Shëroni të sëmurët, pastroni lebrozët, ngjallni të vdekurit, dëboni demonët.“**

Po ky urdhër vlen edhe për të shtatëdhjetët që Jezusi dërgoi. Luka 10,9:

**„Dhe shëroni të sëmurët që do të jenë aty dhe u thoni atyre: Mbretëria e Perëndisë ju është afruar.“**

Jezusi iu premtoi të besuarve se ata do të bënin vepra edhe më të mëdha se ai. Gjoni 14,12:

**„Kush beson në mua do të bëjë dhe ai veprat që bëj unë; madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto, sepse unë po shkoj tek Ati.“**

Tani, ndofta ndonjërit i pëlqen të grindet nëse bënë dishepujt vepra më të mëdha se Jezusi apo jo. Unë jam i bindur se po. Kthimi i 3.000 njerëzve në Rrëshajat tek Veprat e Apostujve me sa di unë nuk ndodh tek shërbimi i Jezusit. Tek Veprat e Apostujve 5,15 na tregohet nga larg për shërbimin e apostujve:

„.... aq sa i binin të sëmurët në sheshe, i vinin në shtretër e në shtroja, që kur kalonte Pjetri, të paktën hija e tij të mbulonte ndonjë nga ata. Edhe një turmë nga qytetet përreth turrej në Jeruzalem, duke sjellë të sëmurët dhe ata që mundoheshin nga frysma të ndyra dhe të gjithë shëroheshin.“

Jezusi nuk e tërroqi kurrë mbrapsht urdhërin e misionit. Nuk gjendet asnjë varg që të pohojë se ky urdhër nuk është më i vlefshëm. Urdhëri tjeter nga Marku 16 përmban nga vargjet 16 deri 20 mendime të ngjashme. Po në këtë mënyrë na dërgon edhe ne Jezuai sot, ashtu siç u dërgua ai vetë. Ai pret që ne të na vijë keq për të humburit.

#### A) Dishepujt e Gjonit:

Ata ishin me Gjonin kur ai bënte thirrje për pendim dhe kur ai pagëzonte të penduarit. Me siguri që ata e ndihmonin për këtë.

#### B) Dishepujt e Jezusit:

Ata nuk u nisën menjëherë pas urdhërit të misionit. Ata ishin të mbushur me frikë. Vetëm pasi u pagëzuan me Frymën e Shenjtë u nisën menjëherë për të zbatuar praktikisht urdhërin e misionit. Tek Vepr. Ap. 2 pas predikimit të Pjetrit ditën e Rrëshajave u kthyen menjöherë 3.000 vetë. E rëndësishme është se burimet jashtëbiblike pohojnë se të gjithë apostujt shkuan si misionarë nëpër botë dhe të gjithë përvçe Gjonit vdiqën si martirë.

#### C) Timoteu:

Pali e udhëzon Timoteun të japë dëshmi pa frikë. Porse qëllimi kryesor i tij është ngritja e bashkësive, vazhdimi i veprës së Palit (letra 1 dhe 2 Timoteut).

## **PARIMI 7:** **Autoriteti dhe nënshtrimi**

Tek të gjashtë shembujt biblikë vërtetohet katërcipërisht se personat shembuj ishin prijesa. Nuk diskutoheshin pyetjet që mund të lindnin ose nuk merreshin vendime p.sh. me anë zgjedhjesh demokratike, por prijesat vendosnin ç'do të bëhej. Nëpërmjet qëndrimit prej shërbëtori dhe gatishmërisë për shërbimet më të ulta u ruajt gjithmonë parimi i autoritetit dhe nënshtrimit. Nëpërmjet gatishmërisë për të shërbyer dhe dëshirës për të mësuar arrihej një atmosferë mësimi, në të cilën dishepulli mund të shprehej, por ku ai gjithashtu ishte i gatshëm të jetonte nën një rregull dhe nënshtrim të qartë. Është e tepërt të përmendim dhe një herë përfundimin biblik në të gjashtë shembujt. Thirrja për dishepullim ngjau me sa shihet nëpërmjet prijesave, shembuje, p. sh. nëpërmjet Elias tek Eliseu, nëpërmjet Jezusit tek dishepujt e tij. Një pikë tjetër është edhe guximi. Të gjithë këta njerëz, këta shembuj, ishin njerëz të guximshëm, të cilët shkuan përpara me vendosmëri pioniere. Dhe po këtë cilësi e gjejmë sërish tek dishepujt. Këtu vërtetohet lehtë së dishepujt që patën mësuar prej tyre ishin njerëz të guximshëm. Kështu p. sh. tregohet për Joshuan tek Joshua 3,4:

**„Sepse deri tani nuk keni kaluar kurre  
nëpër këtë rrugë.“**

Perëndia priste që Joshua të kalonte nëpër një rrugë krejt të re ku ai nuk kish kaluar më parë. Dhe Joshua e bëri këtë. Eliseu iu fut me guxim rrugëve të reja, të parrahura nga shembulli i tij, Elia. Dishepujt qenë gjithashtu të gatshëm të ecnin në rrugë të reja dhe ti përgjigjeshin me guxim thirrjes së Zotit të tyre. Pra, guximi është një virtyt i Frymës së Shenjtë.

Por lavdi Perëndisë - guximi është diçka që mësohet! Gjithshka që na mungon e gjejmë tek Perëndia. Tek 1. Thes. 2,2 thuhet.

„... ne morëm guxim në Perëndinë tonë ...“

Ti duhet të duash të ecësh me Perëndinë në rrugë të reja dhe Fryma e tij e Shenjtë të jep fuqi për këtë. Rruga ime nuk filloj me aksione të mëdha guximi - por lavdi Perëndisë - Zoti që banon në mua kreu një ndryshim rrënjosor. Më tej vlen të thuhet se dishepullimi nuk është një lidhje për gjithë jetën. Dishepullimi është vëtëm një stacion i ndërmjetëm. Dishepulli qëndron për njëfarë kohe pranë shembullit të tij, mëson gjithshka që është në gjendje të mësojë dhe pastaj largohet për të bërë të njejtat gjëra që ka parë, ose edhe më të mëdha se ato që ka parë në jetën dhe shërbimin e personit shembull. Pra, dishepullimi duhet kuptuar brenda një kohe të kufizuar dhe më pas, në një çast të caktuar, lipset të bëhet një shkëputje e qartë. Shpesh në këtë çast bëhet një shtrirje duarsh ose dërgim diku. Nuk është detyra e kësaj broshurke të masë gjithë mundësitet dhe çdo ngjyrim të veçantë në mendimin mbi dishepullimin. Këtu përmenden vetëm gjërat më me peshë dhe më të rëndësishme.

### *Kapitulli 3* *Rreziqet në dishepullim*

---

Natyrisht, çdo parim biblik fsheh edhe rreziqe në vetvete kur zbatohet në mënyrë të gabuar, po kështu edhe dishepullimi. Gjithshka e mirë që jep Perëndia mund të paraqitet në një drejtëm ose në një tjetër si e keqe si pasojë e mbulimeve dhe shtrembërimeve që i bëhen. Rreziku kryesor në dishepullim është i lidhur me parimin e ndikimit të shembullit nëpërmjet një udhëheqësi. Këtu jepet një burim i mundshëm rreziqesh sepse kur një udhëheqës ecën gabim, ka të ngjarë që edhe dishepulli të ecë gabim. Por ky rrezik ndeshet shpesh dhe Bibla na jep një ndihmë shumë të qartë sesi ta dallojmë këtë rrezik. Nuk duhet ecur gabim. Tek Mateu 6,16-20 Zoti Jezus tregon sesi haset ky rrezik: (Fragment)

**„Ju do ti njihni nga fryshtet e tyre. A vilet vallë rrush nga ferrat dhe fiq nga murrizat? Prandaj: nga fryshtet e tyre do ti njihni.“**

Pra, këtu lexojmë se ata mund të njihen nga fryshtet. Mësuesit dhe udhëheqësit në dishepullim kanë një përgjegjësi krejt të veçantë. Përgjegjësia e tyre e lartë qëndron në atë që ata janë vazhdimisht para Zotit dhe tërë jeta e tyre është para Perëndisë. Jeta e tyre duhet të jetë e hapur, e qartë dhe e dukshme. Familja e tyre duhet të jetë e qartë, martesa e tyre duhet të jetë në rregull dhe shërbimi i tyre duhet të vërtetohet me anë të Perëndisë para të gjithë syve.

Në gjashtë shembujt nga Bibla të përshkruar më sipër, shërbimi i këtyre udhëheqsave dhe shembujve ishte i qartë

dhe i ligjëruar dukshëm nga Perëndia me anë shenjash dhe mrekullish në shërbimin dhe jetën e tyre. Dhe në fakt, kështu duhet të jetë dishepullimi. Shërbimi i njerëzve që janë shembuj duhet të vërtetohet qartë nga ana e Perëndisë dhe të ketë unitet ndërmjet familjes, ç'ka do të thotë martesës; dhe shërbimit. Martesa duhet të përputhet me rregullin biblik. Nëse kanë fëmijë këta duhet të jenë fëmijë të bindur, sepse vetëm kështu bëhet i mundur një funksion drejtues në trupin e Krishtit. Bibla e dinte këtë rrezik e megjithatë shkruan me shumë vërtetësi për ti bërë këto gjëra. Nuk mund të lemë pasdore një parim kaq të efektshëm sa parimi i dishepullimit vetëm për hir të një rreziku të mundshëm. Theksojmë edhe njëherë këtu se nëpërmjet 12 d.m.th. 11 dishepujve Ungjilli përshkoi gjithë botën, sepse Jezusi kishte investuar dy vite me rradhë tek këta dishepuj dhe me anë të kësaj u ndez zjarr gjithë bota nëpërmjet Ungjillit. Prandaj, shiko qártë se cilin udhëheqës apo mësues do të ndjekësh pas në drejtim të dishepullimit. Shiko familjen e tij, shiko martesën dhe shërbimin e tij. Sepse do ti njihni nga frytet e tyre. Bëji vetes pyetjen: Cilat fryte sjell ai në shërbimin ndaj Mbretërisë së Perëndisë dhe cilat në jetën vetjake? Bibla e dinte këtë dhe shprehet qartë në mendimet mbi dishepullimin. Ja këtu disa shembuj:

Jezusi tha vazhdimisht: Më ndiq pas.

Mateu 8,22

„Por Jezusi i tha: Më ndiq, dhe leri të vdekurit të varrosin të vdekurit e vet.“

Mateu 9,9

„Pastaj Jezusi, duke shkuar tutje, pa një burrë që rrinte në doganë, i quajtur Mate, dhe i tha: Ndiqmë. Dhe ai u çua dhe e ndoqi.“

Mateu 16,24

„Atëhere Jezusi u tha dishepujve të vet:  
Nëqoftëse dikush don të vijë pas meje, ta  
mohojë vetveten, të marrë kryqin e vet  
dhe të më ndjekë.“

Pali shkruan shumë qartë tek 1. Korintasve 4,16:

„Prandaj ju bëj thirrje të bëheni imituesit  
e mi.“

2. Timoteu 3,10

„Dhe ti ndoqe nga afër mësimin tim,  
sjelljen, këshillat, besimin, durimin,  
dashurinë, ngulmin.“

Dhe në fund letra Hebrejve. Hebrejtë 13,7 dhe 17:

„Kujtoni mësuesit tuaj, që ju shpallën  
fjalën e Perëndisë dhe, duke çmuar  
rezultatin e sjelljes së tyre, merrni si  
shembull besimin e tyre.“

„Dëgjoni mësuesit tuaj dhe nënshtrohuni  
atyre, sepse ata rrinë zgjuar për  
shpirtërat tuaj, si ata që duhet të japid  
llogari; që ta bëjnë këtë me gëzim dhe jo  
me pshëretima, sepse kjo nuk do t'ju sillte  
dobi.“

Këtu pra janë 7 vargje nga Bibla, të cilët na shkruajnë  
qartë për pasnjekjen, të cilat thonë se duhet të ndjekim  
pas mësuesit dhe udhëheqësit dhe se duhet të orientohemi  
për një kohë të gjatë sipas shërbimit dhe jetës së tyre. Ky  
është mendimi biblik për dishepullimin.

## Kapitulli 4

### Përvoja në dishepullim

---

Këtu duă tu referohem përvojave të mbledhura gjatë katër viteve shkolla dishepullimi, të cilat i kam udhëhequr unë me gruan time. Veçanti e këtyre shkollave të dishepullimit është se në çdo shkollë dishepullimi (Kurs katërmujor) veprojnë 15 mësues të ndryshëm, dhe kështu pakësohet shumë rreziku i drejtimit të gabuar me anë të një personi. Një ngjarje të veçantë për udhëheqësin përbën zgjedhja nga një shumicë kandidatësh e nxënësve dishepuj për një kurs të caktuar. Nëpërmjet një grapi prej katër-pesë vetash dhe shumë lutjesh bëhet zgjedhja. Kjo është gjithmonë diçka plot tension. Jemi shumë mirënlohës që Perëndia edhe nëpërmjet dhundive të tij vendos këtu maturi vendimtare. Ne mund të themi se Fryma e Shenjtë është këshilltari ynë në përzgjedhjen e nxënësve. Sigurisht që kjo të kushton shumë kohë, por është gjë e gjëzueshme ta përjetosh në këtë mënyrë Perëndinë. Natyrisht, këtu lind edhe pyetja në e dëgjojmë siç duhet ne zërin e Perëndisë.

Vetëkuptohet, në shkollen e dishepullimit trajtohen edhe tema që kanë të bëjnë me qëndrimin e secilit. Mësohen, ndër të tjera, gjëra të tillë si pendimi, ndërgjegja e pastër, ndreqja e një gabimi, autoriteti dhe nënshtimi, shërimi i shpirtit nga lëndimet, marrëdhëniet me prindërit dhe vellezërit e motrat dhe autoriteti në bashkësi dhe shtet, marrëdhëniet me seksin tjetër. Për gjëzimin tonë, këtu kemi përjetuar herë pas here se ç'ndikim të madh ka Fjala. Shpalleshin dhe pastroheshin mëkate të papastruara deritash, ushtrohej ndreqja e gabimeve në sferën materiale si dhe në sferën njerëzore (në sferën materiale, pjesërisht shuma të mëdha financiare), pastroheshin sërisht marrëdhënie të shkatërruara me prindërit ose me autoritetet

në bashkësinë e Perëndisë dhe bëhej kështu një ngritje cilësore e tyre, ndërtoheshin sërisht marrëdhëniet të tronditura me njerëz të ndryshëm etj ... Kështu, kishim mundësi të shihnim sesi përkujdesej Zoti për qëndrimin e brendshëm shpirtëror. Grumbulloheshin përvaja veçanërisht të thella në lidhje me shërimin shpirtëror dhe çlirimin lidhur me këto shërime. I japim lavdi Zotit për këtë.

Shpresa për lindjen e një bindjeje misionare tek nxënësit dishepuj, është vërtetuar plot herë. Pjesa më e madhe e tyre fituan një zemër keqardhëse për të humburit. Ata janë të gatshëm të harxhojnë lejen vjetore dhe shkojnë të shërbejnë pa sqaruar çështjen financiare. D.m.th. kur shkojnë në shërbim, marrin vetë përsipër shpenzimet financiare. Kështu, një përqindje e lartë shkoi në korrik dhe gusht në javën e Kishës Karizmatike të landit. Një grup më i madh ungjillizoi në një camping veror çadrash. Të gjithë këto aktivitete kushtojnë, e pakta, një javë nga leja vjetore si dhe para për qëndrimin në këto vende (fjetja, ushqimi etj). Të tjerë vëllezër dhe motra bashkëpunojnë nëpër vendfjetore, të cilat janë menduar për fillestarët në besim si dhe për ata që nuk kanë marrë ende një vendim.

Nëpërmjet një nxënësi dishepull ndodhën gjëra të jashtëzakonshme në ushtrinë e DDR, ku ai punonte. Katër nxënës dishepuj lanë vendbanimin e tyre dhe u shpërngulën në Bad Langensalza për të themeluar atje një bashkësi pothuajse nga hiçi. Kjo bindje misionare shprehet edhe tek një vajzë nga Görlitz, e cila pranoi për një kohë të gjatë në banesën e saj një vajzë tjeter, për ti mësuar kësaj hapat e para të besimit dhe për të kontribuar në formimin e një themeli të qëndrueshëm në jetën e saj. Më tej akoma, nxënësit dishepuj përkrahin ungjillizime në vendet ku banojnë.

Si pasojë e këtyre aktiviteteve, në vitet që kaluan, erdhën një numur i madh të rinjsh të besim tek Jezusi. Për herë të parë, në 1987, u bënë ungjillizime të drejtuara kryesisht

nga nxënës dishepuj, ku shumë veta morën vendim për Jezusin. Kjo bindje misionare favorizohet gjatë kursit katërmujor nga, të paktën, dy veprimitari misionare nëpër bashkësi. Realizohen ungjillizime në bashkësitë vendase, të cilat shprehin dëshirën.

Qëndrimi pozitiv ndaj punës praktike është shumë i rëndësishëm për ne. Jo më kot, në kapitullin 2, tek parimi 2, u bë një sqarim i gjerësishëm tek fjala „Shërbim“. Ne e konsiderojmë të rëndësishme kryerjen e punëve praktike si shërbesë nga nxënësit dishepuj. Përvoja e përgjithshme nga shkollat e deritanishme të dishepullimit është kjo: Kush punon me përkushtim dhe tregon rezultate të mira në punën praktike, jep prova të shkëlqyera edhe në sferën frymërore. Ky qëndrim duhet favorizuar paprerë me anë të punëve praktike gjatë periudhës së shkollës.

Përjetohet me gëzim se nxënësit dishepuj marrin pjesë edhe në shërbimet e thjeshta praktike në vend dhe përballojnë punë të thjeshta.

Ne na duket i rëndësishëm aftësimi për bashkëpunim në vend, qoftë në udhëheqje shpirtërore, qoftë në mësimdhënie aty ku ka hapësirë të lirë. Sipas dëshmisë së pastorëve në vend, shumica dërrmuese e nxënësve dishepuj janë të aftë të ushtrojnë udhëheqjen shpirtërore. Shumica e tyre janë në gjendje të organizojnë orët e rinisë në bashkësitë rimore. Ata janë të aftë të japid më tej atë që kanë marrë. Një pjesë e tyre kanë marrë porosi për predikime në ungjillizime të ndryshme ose për predikime në rajone të tjera nëpër kisha tradicionale ose kisha të lira dhe kanë qenë në gjendje ta flasin fjalën e Perëndisë. Në një qytet të landit tonë, dy nxënësa dishepuj shkaktuan një lëvizje për Jezusin në rradhët e rinisë. Ne dëshirojmë me gjithë zemër që nxënësat dishepuj të punojnë ashtu si Jezusi, d. m. th. me predikime, shërimë dhe clirime, ku me predikim nuk kuptojmë vetëm të folurën nga katedra, por edhe përcjelljen e fjalës së Perëndisë nëpërmjet bisedash.

Cuarja më tej e dishepullimit me anë të nxënësve dishepuj bashkë me të rinj të tjerë në vend është, për fat të keq, një pikë që ende vlen të përmirësohet. Ka disa shembuj të mirë, në disa qytete ku me anë të dishepullimit personal u arritën rezultate të shkëlqyera. Por, gjërësisht, këtu nuk mund të ndodhnin shumë gjëra. Puna edukative nga pikpamja udhëheqëse është shpeshherë e vështirë. Natyrisht, është më e lehtë ta inkurajosh dhe ti japësh guxim dikujt. Por edhe qortimi është i domosdoshëm. Në këtë aspekt janë bërë shumë lutje, po, do të thosha, luftë prapa kulisave. I kemi thirrur Zotit kur kemi parë mangësi në zhvillimin e nxënësve tanë. Bëhej fjalë për qëndrime të gabuara ose gjëra të tjera. Dhe duhet të themi se Zoti është shumë besnik. Atë që nuk e bënim dot ne e bëri ai. Edhe sjellja ndaj njeri-tjetrit dhe marrëdhëniet me njeri-tjetrin pësuan në këtë kohë një korrigjim të mirë, aq më tepër që bashkëjetesa në një hapësirë të vogël sjell, natyrisht, probleme të caktuara. Por kjo sjell përparësinë e rritjes në Zotin. Gjithashtu, për marrëdhëniet me njeri-tjetrin qe e nevojshme të flitej mbi rregullat bazë të sjelljes.

Në kohën e lavdërimit praktikoheshin edhe dhunitë e Frymës. Këtu inkurajuam shumë njeri-tjetrin. Dhe sot mund të themi se dhunitë frymërore shpërthejnë më së miri në një atmosferë dashurie të përzemërt ndërmjet nesh. Praktikimi i drejtë i dhuntive frymërore kushtëzohet nga aftësia jonë për të dashur.

Sot e kuptoj përsë 1. Kor.13 - himni i dashurisë - qëndron mu midis 1. Kor.12 dhe 1. Kor. 14. Dhunitë shpërthejnë si duhet dhe më së miri në një atmosferë dashurie.

Katër vite rresht, një fundjave në vit, ne bëним ritakime me nxënësat e dikurshëm dishepuj. Dhe si vlerësim të këtyre takimeve mund të themi se më së miri frymërisht ishin rritur ata që kishin pranuar sfida. Nxënësi rritet më së miri aty ku sfidohet më shumë. Në këto takime të përsëritura ne luteshim për njeri-tjetrin dhe ndërhynim

tok tek Perëndia pér njeri-tjetrin. Po sjell si përfaqsim pér disa gjëra shembullin e një nxënësi. E pranoj se ky është një shembull veçanërisht-guximdhënës, të cilin, në thellësinë e tij, nuk e përjeton dot kushdo. Është M. Kr. nga shkolla e tretë. Kur filloj shkolla e tretë ne kishim para syve një M. të mbushur me frikë, të ndrojtur dhe të térhequr. Pastori i tij i atëhershëm na shkroi një rekomandim 4-faqesh ku na thoshte që, më gjithë difektet, ta pranonim M. në shkollën e dishepullimit. Unë i them sime shoqjeje një javë pas fillimit të shkollës: Tek M. kemi marrë vendim të gabuar. Ai kot sa ka ardhur këtu. Një djalosh kaq të frikësuar, të ndrojtur dhe të térhequr s'ke si e përdor pér Mbretërinë e Perëndisë. Por pastaj, Zoti erdhi mbi M. me dashurinë e tij të madhe dhe me hirin e tij. Në jetën e tij njau një vepër madhështore e Perëndisë. Perëndia e shndërroi atë krejtësisht. Ai nisi të bëjë hapa të guximshëm. Filloi gjithashtu të praktikonte dhunitë e Frymës. Kur, në fund të shkollës së tretë, organizuam veprimtari nëpër bashkësi, duhet të them pér nder të Zotit se M. qe më i guximshmi nga të gjithë. Në një qytet të landit tonë, në tregun e Krishtlindjeve, ai para shumë njerëzve u lut me dikë që ia dha jetën Zotit. Kur bëmë një aktivitet në një diskò, qe po ai që pas një pantomime u lut me dikë që ia dha jetën Zotit. Në DDR-në e atëhershme këto gjëra ishin të ndaluara. Kur ai më vonë shkoi të shërbente pér një vit pranë një prifti, udhëheqësi i tij i rrethit të shtëpisë tha se nga rrethi i shtëpisë ishte larguar një pjesë e substancës fryshtësore. Ne e lëvdojmë Zotin pér ato që bën. Me siguri ne kishim vetë nevojë pér këtë inkurajim. Emri i Zotit qoftë lëvduar.

Edhe një vërejtje në fund: Edhe nëpërmjet shkollave të dishepullimit nuk arrihet një rezultat 100 %. Jo gjithkush që merr pjesë në një shkollë dishepullimi bën më pas një jetë plot forcë dhe plotfuqi. Por lavdi Zotit, pjesa më e madhe. Por 100 % nuk arrihet.

Për mua është një ngushëllim i madh që vetë Jezusi kishte ndër të 12 dikë (Juda), i cili qe tërë kohën pranë tij dhe i cili dështoi më vonë në situatën vendimtare. Por, megjithë dështimin tonë njerëzor Zoti është mëshirëmadh. Vetëm emri i tij u lavdëroftë.

## *Kapitulli 5* *Dishepullimi personal*

---

Testamentin e Jezusit në fund të jetës së tij në tokë, e lexojmë tek Mateu në urdhërin e misionit:

Mateu 28,18-20

„**Pastaj Jezusi u afrua dhe u foli atyre duke thënë: Mua më është dhënë cdo pushtet në qiell dhe në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë gjithë gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.**“

Jezusi këtu nuk tha, bëjini kristianë gjithë popujt, por bëjini dishepuj gjithë popujt. Ai vetë, që e jetoi dishepullimin në formën më të qartë e evidente, i thotë dishepujve të vet, tani bëni ju dishepuj. Këtu madje kemi një **urdhër** për dishepullim. Me fjalë të tjera ai thotë, bëni me të tjerët atë që unë bëra me ju. Dhe ai ua kishte treguar me shembullin e vet sesi fillon dishepullimi, d.m.th. me lutje!

Jezusi ishte lultur një natë të tërë para se të zgjidhte 12 dishepujt e tij, të cilët ai i quante edhe apostuj.

Luka 6,12-13

„**Në ato ditë ndodhi që ai shkoi në mal për t'u lultur, dhe e kaloi natën duke iu lultur Perëndisë. Dhe kur zbardhi dita, thirri pranë vetes dishepujt e vet dhe zgjodhi**

**prej tyre dymbëdhjetë, të cilëve u dha  
dhe emrin apostuj.“**

Në vargjet pasuese na përmenden emrat e dymbëdhjetë dishepujve. Po këtë duhet të bëjmë edhe ne, kur thërrasim njerëz për dishepullim.

**Hapi i parë pra,** duhet të jetë. Në lutje serioze, Perëndia të na tregojë ata njerëz, të cilët do të janë pranë nesh për një kohë të gjatë në dishepullim. Shpeshherë janë ata njerëz, të cilët ne i kemi sjellë tek Jezusi ose të tjerë, të cilët tashmë e njohin Jezusin. Pra, çdo gjë fillon me lutje serioze dhe jo duke u menduar! Nëse Jezusi harxhonte një natë para se të caktonte dikë në një détyrë, këtu edhe ne duhet të mësojmë prej tij!

**Hapi i dytë** do të ishte thirrja praktike në dishepullim duke i thënë dikujt: Dua të tē jap ty gjatë njëfarë kohe atë që unë kam marrë nga Perëndia. Më e qartë kjo bëhet me anë të shembullit të një fëmije: Me sa mund u mësojmë fëmijëve tanë tokësorë gjëra të caktuara ose mënyra të sjelljes. Prindërit harxhojnë shumë kohë dhe mund kur fëmija zë të ecë ose sidomos mamaja kur fëmija mëson të tregojë kohën e jashtëqitjes ose gjëra të ngjashme. Po kështu duhet të mësojnë kristianët e rinj gjëra të caktuara në mbretërinë e Perëndisë dhe atyre mund t'u thuhet, është krejt normale sepse ne kemi ecur vetë në rrugën e mësimit dhe ti pastaj do të shohësh nëse filani është gati ta ndjekë këtë thirrje, nëse ai është gati ta paguajë çmimin që kushton kjo gjë. Pastaj do të dallosh nëse ishte e saktë apo jo përshtypja që ti pate gjatë lutjes.

**Një hap të tretë** hedhim kur themi: Ky do të jetë një mësim i kufizuar në kohë. Mëso gjithshka që ke mundësi dhe që sheh. Të marr me gjithë qef nëpër shërbimet ose gjérat që

bëj për Mbretërinë e Perëndisë, por koha jote e mësimit do të jetë e kufizuar. Shpresoj të mbetemi miq për një kohë të gjatë ose ndoshta gjithë jetën, por kjo marrëdhënie mësimi dhe qëndrimi sëbashku do të zgjasë vetëm një kohë të caktuar, derisa të përfundoj procesi i të mësuarit.

Me siguri, është mirë të bëhet e qartë qysh në fillim se kjo nuk është një lëdhje për gjithë jetën! Por ky proces mësimi duhet të jetë intensiv, në mënyrë që ata, të cilët t'i ka dhënë Perëndia, të mund të mësojnë gjithshka që di dhe bën ti dhe pastaj, pa u bërë ziliqar, t'i lejosh të veprojnë në Mbretërinë e Perëndisë edhe nëqoftëse ata ta kalojnë. Por, me siguri që edhe ti nuk do të mbetesh në vendnumuro. Bëj vetëm atë që bëri Jezusi: Ai i inkurajonte njerëzit kur kishin nevojë për inkurajim, i ndërtonte, filloi në një moment të caktuar t'u shërbente edhe vetë atyre. I korrígjonte dhe i qortonte në gjëra të ndryshme; ai pra, qe gati ti korigjonte në jetën e tyre.

Një hap i katërt do të ishte ndërprerja e marrëdhënieve dishepullore pas një kohe të caktuar. Pastaj, me anë të shtrimit të duarve, duhet të pasojë lejimi ose çuarja në një shërbim të caktuar. Ky shtrim duarsh nuk është i detyrueshëm por mund të sjellë dobi dhe pastaj i thua këtyre njerëzve që të ka dhënë Perëndia: Tani bëni me ata që do t'ju tregojë Perëndia të njejtën gjë që unë bëra me ju!

Po ta zbatojmë këtë parim vërtet me besnikëri, besim dhe përkushtim, do të kemi shumë sukses.

Ne të gjithë presim një zgjim të thellë dhe depërtues. Në këtë zgjim Perëndia do të na japë shumë njerëz dhe varet vetëm nga ne, a do të jemi në gjendje, nëpërmjet dishepullimit personal, të mësojmë njerëz të aftë për të mbajtur gjérat e Perëndisë. Së fundi, një shembull nga një ish-nxënës dishepull, i cili shkoi në një vend për të udhëhequr punën me të rintë në një bashkësi. Ai nuk arriti

të mblidhët në këtë grup një numur të pafund të rinjsh, por investoi tek disa të rinj inkurajim dhe korigim dhe këta të rinj sot janë duke u bërë vetë udhëheqësa: Një çift bashkëshortësh ndoqi një shkollë biblike, një vajzë e re ndoqi një shkollë dishepullimi, kristianë të tjerë atje u influencuan pozitivisht prej tij në atë mënyrë që ata tani qëndrojnë fort në besim. Kështu u shumëfishua puna e këtij vëllai sepse parashikohet që këta njerëz të mësuar do ti shërbejnë me udhëheqjen e tyre Perëndise brenda një kohe të shkurtër! Unë vetë në shërbimet e mia kam shumë shpesh pranë vëllezër të rinj të misionit, të cilët më mbështesin në shërbim dhe dëshirojnë të mësojnë dhe të zbatojnë gjërat e Perëndisë. Unë kam vendosur t'i lejoj të ma kalojnë në besim. Por edhe unë nuk do të rri në vendnumuro dhe do ec më tej me Zotin. Është urdhëresë urtësie dhe mbrojtjeje që të tregojmë kujdes që lidhje të tillë dishepullimi të zhvillohen, brenda mundësive, midis një vëllai me vëllezër dhe një motre me motra. Këtu krijohet mbrojtje, në mënyrë që dishepullimi të mos kalojë në një fazë të pakëndshme sepse nuk është ky qëllimi i dishepuillimit. Nga e kaluara kemi disa shembuj shumë të njobur në USA, ku u shkatërruan shërbime të tëra (shërbime shumë të mira dhe të suksesshme) sepse ekzistonin dobësi karakteri.

Dishepullimi ëshë një rrugë e asgjësimit të dobësive të tillë të karakterit. Ne të gjithë presim një zgjim depërtues në vendin tonë dhe ne do ta përjetojmë atë. Varet sa udhëheqësa të qëndrueshëm do të kemi, të cilët do të jenë në gjendje ta kapin këtë zgjim.

Prandaj është e rëndësishme kjo pleduajë për dishepullimin personal! Le të punojmë ashtu si punoi Jezusi. Ndoshta në të kaluarën-kemi humbur kristianë të sapokthyer sepse ne nuk ishim vetë të përgatitur të paguanim çmimin e dishepullimit, çmim të cilin duhet ta paguajë edhe ai që bën dishepullim me të tjerët.

Është shumë pak t'i thuash një kristiani të posakthyer: Tani merr e lexo Biblën, lutu dhe shko nëpër mitingje dhe rritu kështu në besim sepse këto janë të gjitha gjëra të mira dhe të drejta.

POR! Dishepullimi është shumë më tepër se kaq dhe është një rrugë për të penguar që kristianë të porsafituar të kthehen prapë tek bota. Kemi parë të vdesin shumë bebe në të kaluarën! Perëndia don të na japë urtësi dhe hir në dishepullimin personal!

Për këtë temë është veçanërisht prekëse një dëshmi nga Burma. Një mësues (Gerhard Linn) na tregoi në shkollën e parë të dishepullimit një shembull prekës për dishepullimin. I pari misionar që shkoi në Burmë (një baptist) filloi të punojë atje në mënyrën e zakonshme, d.m.th. duke mësuar gjuhën etj. Pastaj, për plot 18 vjet investoi vetëm tek 10 njerëz. Po lexoni tamam, 18 vjet në 10 njerëz. Mund të bëhet pyetja: A është efektive kjo? Por ai duroi sepse e dinte shumë mirë që kur të largohej nga ai vend, të paktën këta njerëz duhet të ishin në gjendje të përcillnin më tej ungjillin.

Kur ai më në fund u detyrua të largohej nga vendi, këta dhjetë njerëz qenë në gjendje ta shpallnin ungjillin në gjithë Burmën. Sot në Burma ka rreth 1,5 milionë baptiste dhe kjo në një kohë relativisht të shkurtër nuk mbaj më mend sesa. Ky misionar e ka kuptuar siç duhet parimin e dishepullimit.

## *Mbyllje*

Shkurt disa gjëra nga përjetimet e mia: Shërbesa ime në Mbretërinë e Perëndisë filloj ashtu që unë u pastroja këpucët burrave të Perëndisë që vinin në shtëpinë tonë. Jam mirënjojës që prindërit e mi mbanin shtëpinë hapur. Në këtë shtëpi e kalonin natën shumë burra të Perëndisë. Unë isha shumë i gjuar që u pastroja këpucët. Aty-këtu kapte edhe veshi im fluturimthi ndonjë histori, një vlerësim etj. Më ka mbetur i paharruar tregimi i një dëshmie ngajeta e një vëllai, e cila lidhet me futbollin, sesi Perëndia e mori atë nga një karierë e madhe si futbollist në shërbim të tij. Tamam në këtë pikë isha unë në atë kohë. I jam shumë mirënjojës Zotit për këtë.

Në jetën time fryshtore, përvèç prindërve të mi, kanë kontribuar edhe 6 vëllezër të besimit. Më shkon mendja sidomos tek im gjysh, i cili themeloi bashkësinë në vendin tim të lindjes (në lagje). Nëpërmjet një pune të përkushtuar ndaj Perëndisë ai krijoj në pak vite nga hiçi një bashkësi të lulëzuar me rreth 40 anëtarë. Prej tij mësova qëndrueshmërinë dhe përkushtimin. Mësova t'u jap përgjigje pyetjeve të rëndësishme, por ama pas ditë të tëra lutjesh. Prej tij mësova të kem një qëllim të qartë. (Megjithatë, kjo nuk më ruajti nga gabimet. Shumë herët u bëra udhëheqës rinie kur isha ende i paaftë të udhëhiqja të rinjtë dhe atje pata një mossukses vendimtar.) Pastaj i detyrohem veçanërisht prindërve tanë shpirtërorë, çiftit Knoll. Ata na udhëhoqën në pagëzimin e Frymës (por vetëm pas studimit personal të Biblës). Ata na udhëhoqën drejt rinimit shpirtëror, na mësuan përkushtimin dhe filluan të na tregojnë sesi të armatosemi për luftën e besimit. Ne - ime shoqe dhe unë - i detyrohem i atyre me dashuri dhe falenderim. Zoti na vuri me anë të tyre në binarët e

duhur në momentet vendimtare të jetës sonë. Një tjetër pastor, Th.K., qe për ne një ndihmë vendimtare. Ne mësuam tek ai me anë të të parit armatimin për luftën e besimit, provimin dhe përdorimin e dhundive të Frymës. Kemi parë me vëmendje, kemi mësuar dhe veçanërisht i kemi lejuar prindërit tanë shpirtërorë të thonë fjalën e tyre në jetën tonë. Kemi parë sesi jetonin ata. Kemi parë se ç'bënин në raste sëmundjesh, bezdisjesh, shqetësimesh, si silleshin në adhurim etj ... Dy vëllezër na mësuan besimin biblik dhe përdorimin e fuqisë së Perëndisë. Nëpërmjet tyre hymë në dimensionet e shërimit të sëmundjeve dhe mësuam të praktikonim shërbesën e çlirimit.

Historia e kishës na mëson se shumë vepra besimi, të cilat i themeluan burra dhe gra të Perëndisë, nuk vazhduan më pas vdekjes së tyre ose nuk vazhduan më në fuqinë e Perëndisë. Me vdekjen ose me ndarjen ngajeta të këtyre njerëzve këto vepra e humbën fuqinë e tyre shpirtërore. Kjo duket sheshit. Do ishte e lehtë të jepnim këtu 5,6,8 shembuj. Kështu, mua më ka bërë përshtypje një burrë i Perëndisë i ditëve tona, Herman Rieflle. Gjatë një vizite në DDR-në e dikurshme ai na prezantoi pasuesin e tij. Në atë kohë Herman Rieflle ishte rrëth të pesëdhjetave dhe pasuesi i tij rrëth të tridhjetave. AI tha njëherë: „Ky është pasuesi im.“ Pra, nëse ajo vepër besimi, e cila nisi në Altensteig me Herman Rieflen, do ta humbasë dikur themeluesin e saj Herman Rieflen, ajo do të vazhdojë në të njejtën mënyrë në Fuqinë e Perëndisë. Unë via re se Herman Rieflle e merrte mënjanë pasuesin e vet për të biseduar, mbasi ky i fundit kishte dhënë mësim ose kishte profetizuar. Se ç'flitej atje nuk e di, por mendoj se ishte inkurajim, qortim ose korrigjim.

Në fund, edhe njëherë fjala e plotë për dishepullimin nga 2. Timoteu 2,1-3:

**„Ti, pra, biri im, forcohu në hirin që është në Krishtin Jezus; dhe ato që dëgjove nga unë para shumë dëshmitarëve, jepua njerëzve besnikë, që do të janë të aftë të mësojnë edhe të tjerë. Ti, pra, duro pjesën tënde të vuajtjeve, si një ushtar i mirë i Jezu Krishtit.“**

Identiteti ynë qëndron tek Jezusi. Ne jemi të siguruar në Të nëpërmjet hirit të tij. Nuk janë sukseset siguria jonë, por Ai vetë, emri i tij, prania e tij janë të mjaftueshme për ne. Nëse e formësojmë në këtë mënyrë dishepullimin dhe investojmë në njerëz të tjerë besnikë, të cilët janë të aftë ta përcjellin më tej këtë investim, atëhere ky është dishepullim në kuptimin biblik. Dhe këtu është normale që ne ta bëjmë këtë dhe të kemi pjesën tonë të vuajtjeve. Pra, nëse ecën në rrugën e dishepullimit do të kesh edhe vuajtje.

Përbledhshëm tre hapat, për tu bërë burrë ose grua e Perëndisë (shih edhe kapitullin 1. Joshuas).

### **1. Të jesh shërbëtor:**

shërbime praktike për udhëheqësin dhe pranë udhëheqësit

### **2. Të jesh dishepull:**

të vazhdosh të shërbesh, të shohësh, të parashikosh dhe të kryesh shërbime të vogla frymërore

### **3. Udhëheqës i popullit:**

të mbash përgjegjësi për njerëzit

C

Në misionin „Joshua“ kanë dalë në shqip studimet e shkurtëra të mëposhtme:

<b>Nr.2</b> Pagëzimi me Shpirtin e Shenjtë	Eckhard Neumann
<b>Nr.5</b> Pagëzimi me ujë	Matthias Hüttl
<b>Nr.6</b> Shpirtërafituesi	Larry Lea
<b>Nr.7</b> Të njohësh Perëndinë	Russ Doty
<b>Nr.8</b> Martesa dhe Familja	Christel dhe Eckhard Neumann
<b>Nr.9</b> Shpëtimi dhe rilindja	Winfried Rudloff

Eshtë vënë në dispozicion një ofertë me kasetë mësimi dhe predikimi si edhe kasetë me muzikë (lavdërim).

Adresa e porosisë  
Christliches missionswerk „Josua“  
Kirchsteig 6  
12524 Berlin / Germany

Misioni „Joshua“  
Lagja „Partizani“  
Rrugë „Brigada 15“ Nr. 17  
Elbasan, Albania / Shqipëri



ECKHARD NEUMANN, datëlindja 1937, i martuar, 4 fëmijë, 4 nuse e dhëndurë, 10 nipa e mbesa, është udhëheqës dhe themelues i Misionit Kristian „Joshua“ në Berlin, i cili punon për rinimin e jetës shpirtërore, kryesisht në zonën e DDR-së së dikurshme.

Perëndia e ka përdorur shërbimin e tij për të themeluar një numur bashkësish të reja dhe për të futur disa gjëra të reja në DDR-në e dikurshme. Ai punon në udhëtime-shërbime mësimore nëpër bashkësi të ndryshme dhe në shkolla.



---

Jezusi i stërviti dishepujt rrëth 3 vjet dhe përshkoi gjithë botën me ungjillin. Cështjet tepër aktuale të shkollimit të karakterit, shërbimit, nxënies etj. janë pyetje thelbësore të shkollimit të bashkëpunëtorëve dhe drejtuesve.

Më tej, ky studim i jep përgjigje pyetjes së rëndësishme: „Si të bëhem njeri i Perëndisë“.

